



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ANEKS NR.1

FORMULARI I ANKESËS

I.

INFORMACION MBI TË DHËNAT PERSONALE TË ANKUESIT			
Emri/Mbiemri i ankuesit: Emri/Mbiemri i personit juridik:	MARIO ROSI		
Nr. Personal/Shtetësia:	A123456789B SHQIPTAR		
Emri/Mbiemri i Përfaqësuesit të personit juridik:	---		
Adresa e përhershme:	Rr.Pjetër Budi, Pallati nr.20, Shkalla 2, Apartamenti 5 Tiranë		
Adresa për korrespondencën (nëse është e ndryshme nga adresa e përhershme)	----		
Adresa elektronike (e-mail)	mariosi@yahoo.com		
Numrat e telefonit	Nr. fiks: 041234567	Punë/Zyrë:	Celulari: 0691234567
Forma e ankesës	<input type="checkbox"/> Me postë elektronike <input type="checkbox"/> Personalisht <input checked="" type="checkbox"/> Me postë të rregullt <input type="checkbox"/> Faks		
Konfidencialiteti i identitetit	Kërkoni të ruani konfidencialitetin e identitetit tuaj? Po <input checked="" type="checkbox"/> <input type="checkbox"/> Jo		

II.

INFORMACION MBI TË DHËNAT E SUBJEKTIT

Subjekti ndaj të cilit drejtohet ankesa:

- Gjyqtar
 Prokuror
 Anëtar KLGJ
 Anëtar KLP
 Prokuror i Përgjithshëm

Emri dhe mbiemri i subjektit: MARKO MORO

Gjykata/Prokuroria në të cilën gjyqtari/prokurori ushtron ose ka ushtruar funksionin në kohën kur ka ndodhur shkelja e pretenduar: Gjykata e Apelit Tiranë

III.

OBJEKTI I ANKESËS

Shkelja disiplinore e pretenduar është:

- në lidhje me ushtrimin e funksionit
 jashtë ushtrimit të funksionit
 për shkak të kryerjes së veprës penale

Cila është ankesa juaj?

(Ju lutemi jepni detaje mbi faktet, rrethanat dhe datën se kur ka ndodhur shkelja e pretenduar)

Pretendoj se Gjyqtari Marko Moro ka kryer shkelje të rënda të standardit të procesit të rregullt ligjor dhe shkelje të rënda të etikës profesionale.

Në dt. 2 Shkurt 2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me trup gjykues të përbërë nga Gjyqtari Marko Moro, është zhvilluar seanca e veprimeve përgatitore për çështjen civile, në të cilën unë isha paditësi. Si paditës, kërkova që të përfaqësohem nga një avokat. Nisur nga ky fakt u paraqita në seancë bashkë me avokatin.

Gjykatësi Moro, në kuadër të veprimeve përgatitore më kërkoi që të evidentoj adresën e plotë. Pasi u verifikua se kam depozituar të gjitha provat e nevojshme për gjykim, ku ndër të tjera evidentohet edhe adresa ime, Gjyqtari më kërkoi informacion duke më pyetur se përse fletëthirrja është nënshkruar nga ana e avokatit tim. Lidhur me këtë zvarritje pa arsye të seancës, jam shprehur se në mendimin tim ky ishte një detaj i parëndësishëm. Në kete moment Gjyqtari Marko Moro më është drejtuar me fjalë fyese dhe diskriminuese duke thyer etikën qytetare dhe atë të gjyqtarit. Pas kësaj, më ka mohuar të drejtën e përfaqësimit me avokat duke e quajtur si jo legjitim.

	Të gjitha sa më sipër, kanë ndodhur në séance dhe nga ana ime është e pamundur të vërtetohen. Kërkoj prej jush të faktohen pretendimet e mia dhe të merren masat e duhura disiplinore ndaj Gjyqtarit Marko Moro, sipas legjislacionit në fuqi.
--	--

IV.

OPSIONALE	
Nëse ankesa juaj ka lidhje me çështje gjyqësore/nën hetim, ju lutemi plotësoni informacionin përkatës në fushat e mëposhtme. Nëse jo, vazhdoni me plotësimin e pjesës IV	
INFORMACION NË LIDHJE ME ÇËSHTJEN	
Numri i çështjes	12345
Lloji i çështjes Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse!	<input checked="" type="checkbox"/> Civile Administrative <input type="checkbox"/> Penale
Përfshirja e ankuesit në çështjen e lartpërmendur: Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse!	<input checked="" type="checkbox"/> Paditës <input type="checkbox"/> I paditur <input type="checkbox"/> I pandehur <input type="checkbox"/> Ankues <input type="checkbox"/> Avokat <input type="checkbox"/> Dëshmitar <input type="checkbox"/> Tjetër Nëse tjetër, ju lutem specifikoni _____
Faza aktuale e procesit	<input type="checkbox"/> Në gjykim <input type="checkbox"/> Pas gjykimit <input checked="" type="checkbox"/> Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë <input type="checkbox"/> Gjykatë Apeli <input type="checkbox"/> Gjykatë e Lartë <input type="checkbox"/> Nën hetim <input type="checkbox"/> Prokuroria e Shkallës së Parë _____ <input type="checkbox"/> Prokuroria e Apelit _____
A jeni ankuar më parë për të njëjtat fakte? Ju lutemi, shënoni në kutizën përkatëse dhe parashtroni të dhënat e kërkuara!	<input type="checkbox"/> Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo Numri i regjistrimit i ankesës dhe/ose numri i çështjes tek Zyra e Inspektorit: _____

V.

OPSIONALE
LISTA E DOKUMENTEVE BASHKËLIDHUR
1. Ankesë padi me nr.1234 prot.

VI.

KËRKESË E VEÇANTË, KONFIDENCIALITETI

Deklaratë konfidencialiteti

Me anë të kësaj deklaratë Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, merr përsipër të mos përdorë dhe të mos i transmetojë personave të paautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me ose të marra nga ankuesi, përveç nëse autorizohet shprehimisht nga ky i fundit, ose kërkohet me ligj. Ky detyrim vlen për çdo fazë të shqyrtimit të ankesës.

Përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët, trajtohet nga ligji nr.9987, datë 10.03.2008 për “Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk do të përdorë ose përhapë asnjë të dhënë personale që merr dijeni gjatë veprimtarisë së tij për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me veprimtarinë e tij.

Në çdo rast informacioni i paraqitur konsiderohet konfidencial dhe do të përdoret vetëm nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (I.L.D.) për qëllime të shqyrtimit të ankesës.

Shënim: Nëse pjesë të caktuara të formularit janë të pamjaftueshme për deklarimin e të dhënave, mund të shtoni pjesë sa ju nevojiten për pasqyrimin e të gjitha të dhënave.

14.06.2021

Mario Rosi

Data

Nënshkrimi i Ankuesit/
Përfaqësuesi i Ankuesit